



Titulli i projektit

Krijimi i entiteteve të përpunimit të produkteve blegtorale (Bashkia Klos dhe Mat)

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik nëpërmjet zgjerimit të të ardhurave nga produktet vendore

Vendndodhja e projektit

Të gjitha komunat e FA Mat-Klos

Buxheti i paravlerësuar

31,800,000 Lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Zona e Matit dhe e Klosit dallohet për cilësinë e veçantë të produkteve blegtorale, për arsye të klimës, bimësisë dhe ujërave të bollshme. Megjithatë, kjo zonë nuk ka asnjë impiant të përpunimit të këtyre produkteve, çka bën që nënproduktet të mbeten në tregun lokal. Ato nuk përbushin standardet e cilësisë për të kaluar në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare. Investimet në këto impiante do të rrisnin cilësinë e produkteve, mundësitë për eksportim dhe të ardhurat familjare në zonën funksionale.

Qëllimi/et specifik të projektit

Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, duke shfrytëzuar avantazhet krahasuese dhe konkurruese vendore në produktet blegtorale.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Investimi në njësi të përpunimit të produkteve blegtorale në territorin e bashkive Mat dhe Klos, me kapacitet deri në 1 ton në ditë për njësitë e përpunimit të qumështit dhe 800 kg në ditë për mishin (2 baxho dhe 1 sallameri të ndërtuara në territorin e Zonës Funksionale);
- Rritje e volumeve të shitjeve dhe të të ardhurave për fermerët vendas nga tregtimi i produkteve vendase në tregun lokal, rajonal dhe kombëtar (volumet e shitjeve dhe të të ardhurave në shkallë vendore më të larta se në tre vitet e fundit, para ngritjes së këtyre njësisve).
- Zhvillimi i markave lokale të regjistruara të produkteve vendore (secila nga shoqatat të ketë markën e vet të produktit përkatës);
- Lidhja me institutet rajonale dhe kombëtare të bujqësisë/blegtorisë për mbështetjen me programe formimesh në teknologji dhe metoda moderne përpunimi, në përputhje me kushtet klimatike të zonës (lidhje dhe memorandume të bashkëpunimit të nënshkruara me Ministrinë e Bujqësisë dhe institutet e varësisë).



Aktivitetet e projektit

- Studimi i Fizibilitetit të investimeve dhe kërkesës për kredi;
- Negocimi i kredisë me kushte lehtësuese pranë një institucioni financues (donator, bankë, apo institucion mikrofinance).
- Akordimi i kredive dhe fillimi i investimeve. Vënia në punë e njësive përkatëse dhe tregtimi i mallrave të përpunuara;
- Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe i sistemit të çertifikimit të këtyre markave nga institutet e garantimit të cilësisë.

Maturimi i projektit

Nuk ka një koncept fillestar dhe fazë paraprake të këtij projekti.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e Financimit:

- Donatorët;
- Bankat dhe institucionet financiare.

Partnerët:

- Ministria e Bujqësisë, drejtoritë rajonale të bujqësisë, institucionet e varësisë;
- Donatorë: BE, BB, USAID, GIZ;
- Banka: BERZH, ProCredit, Institutet e Mikrofinancës.

Kostot e projektit

Studimi i Fizibilitetit të investimeve dhe kërkesës për kredi 800,000

Negocimi i kredisë me kushte lehtësuese pranë një institucioni financues (donator, bankë, apo institucion mikrofinance). 0

Akordimi i kredive dhe fillimet e investimeve. Vënia në punë e njësive përkatëse dhe tregtimi i mallrave të përpunuara 30,000,000

Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe i sistemit të çertifikimit të këtyre markave nga institutet e garantimit të cilësisë. 1,000,000

Total: 31,800,000